

ANALIZA E ROMANIT “PRILLI I THYER” I ISMAIL KADARESË DHE FILMIT ” BEHIND THE SUN ‘

Sevdije AJETI

^{1*} Instituti i Letërsisë Maqedonase, studime kulturologjike²

^{*} sevdije.ajeti@iml.ukim.edu.mk, sevdijeajetis@gmail.com

Abstract

From the beginning of this study, we show our comparative approach between the two artistic mediums of prose, namely the novel and the film. The film adaptation of the novel that we have selected for analysis is a great work that requires effort and theoretical knowledge, reading and rereading of the novel, knowledge of Albanian culture, tradition and canon. Our study is based on the inner world of the main character, and how he carries the idea of the writer and how that idea is transferred to the film adaptation. It happens from the Brazilian production, from the director and senior screenwriters to the culture and from the traits that create a small scientific dilemma.

Both in the novel and in its film adaptation, the character of Gjorgu begins to appear a clear path in the aspects of his bad and tragic fate and even repetitive.

The fact that he lived in such a region is part of the reason for his fate. In his character that is neatly preserved both in the novel and in the beginning.

Abstrakt

Që në fillim të këtij studimi, tregojmë qasjen tone krahasuese mes dy mediumeve artistike të prozës pra romanit dhe filmit. Ekranizimi i romanit në të cilin kemi përzgjedhë për analizë është një punë e madhe e cila kërkon mund dhe dije teorike, lexim dhe rilexim të romanit, njohje të kultures, traditës dhe kanunit shqiptarë. Studimi jonë mbështetet të bota e brendshme e personazhit kryesor, dhe si ai bartë idenë e shkrimtarit dhe si ajo ide transferohet në ekranizim. ndodh nga produksioni Brazilian, nga regjisor dhe skenaristë të lartë për nga kultura dhe nga traitat që krijojnë një dilem të vogël shkencore.

Edhe në roman por edhe në ekranizimin e tij në film, personazhi i Gjorgut fillon të shfaqet rrugë e qartë në aspekt të fatit të tij të keq dhe tragjik madje dhe përsëritës.

Fakti që ai jetonte në një rajon të tillë, është një pjesë e shkakut për fatin e tij. Në karakterin e tij që mjeshtërisht ruhet dhe në roman dhe në fillim.

Fjalë kyçe : roman , letërsia dhe film, projeksion, tekst dhe film imazh , adaptim

Hyrje

Ne romanin “ Prilli i thyer” ka shumë të dhëna, nganjëherë pothuajse dokumentare, detajore, në imtësi të kodit të besës, kanunit e gjakmarrjes, Autori Ismail Kadare mbërthen idealet e çdo të riu shqiptar, tentimin për ndryshim, në anën tjetër, kemi vepren e ekranizuar me elemente të kultures braziliene me një ide kanunore shqiptare nga një personazh i bartjes së ides -shqiptar në një personazh Brazilian. Vrasja e një personi, gjakmarrja, ishte detyrim, mirëpo nuk përkonte me karakterin e personazhit sepse ai u detyrua nga i ati dhe traditat e malësisë në rastin e romanit ndërsa në rastin e filmit ai i nënshtrohet traditës dhe kultures brazilianëve ,në film kemi shumë elemente që e pasurojnë kinomatografine nga vete koncepti vezual I skenaristit , regjisorit ku perveq lojës së personazheve paraqiten simbole të kanunit si element simbolike. Gjatë leximit të romanit lexuesi futen në botën e personazheve ku me imagjinatën e tyre vijnë deri te perceptimii personazheve , kurse në film” regjisorin na I servon personazhet se si duken që përmes tyre njihemi me temën, me situatën me veprimet. Mirëpo jo gjithmonë një vepër e mire bëhet film I rirë . filmi ;;Behind the Sun” përveq lojës së personazheve që paraqiten

permes syrit të kamerës, ngjyrave–piktur ,ku dominon ngjyra e ndezur me një ambient gjysmë hënor. Në kinomatografi veprat kanë një ndikim të fuqishëm tek regjisorët dhe skenaristët duke mundësuar që me gjuhën e filmit të ringjallim edhe veprë letrare.

Te *Prilli i thyer*, i Kadaresë, personazhi kryesor I cili flijohet është Gjorg Berisha, I kalon në një personazh tragjik, bëhet dhe vrasës nga presioni dhe rregullat e kanunit. Kadare e vë personazhin tragjik-Gjorgun nën zgjedhën e kanunit. Po në film “Behind the sun” , aty përdorën skena tipike të kultures braziliene, përshirë këtu dhe muzikën dhe vallen braziliene. Por, krahas personazhit të Gjorg Berishës vendoset edhe personazhi i Besian Vorbsit – një shkrimtar, që ka një grua të bukur, Dianën. Përmes Gjorgut, Besianit dhe Dianes , Kadareja shpalos dramën e malësorëve dhe të Gjorgut, si figurë tragjike që shkëlqen si meteor, për t’u shuar tragjikisht në një udhëkryq po aq shpejt, pa dramë, pa ofshama. Gjorgu është një tip personazhi shumë i qetë, nuk bën asnjë përpjekje të kundërshtojë as më pak i shkon nëpër mend që të mos e zbatojë Kanunin. Ndersa personazhi ne filmit “Behind the sun” e kundërshton jo vetem kanunin por edhe babain e tij.

Te romani *Prilli i thyer* i Kadaresë, personazhi i Gjorgut, i cili në anën tjetër ka një anonimat, nëpërmjet të cilit përgjithësohet dukuria e njohur për lexuesin e romanit të Kadaresë: *pushteti totalitar. Kategoria e së keqes*, që më pas do prodhojë dhe flijimin, është prezente gjatë gjithë rrëfimit, e karakterizuar nëpërmjet gjendjes amorge, në të cilën ndodhen personazhet dhe me një shtresëzim simbolik të shprehur përmes personazhit. Ideja e veprës është pikërisht se “gabimi dhe çmenduria e kanunit, gjenden më shumë në zanafillën prej nga ka lindur ne lashtësi, sesa në shoqëri e sotme”,

Personazhi i mikut, miti i mikut te *Prilli i thyer*, është një tregues i karakterit mikpritës të shqiptarëve, një tjetër tipar i rrallë, me të cilin mund të krenohet kombi ynë. Shtëpia“Është e zotit dhe e mikut, gjaku i babës ose i djalit mund të falet kurse i mikut, kurrë!”. Ja si përshkruhet në roman: “Miku është tamam gjysmë perëndi, - dhe fakti që çdo njeri i zakonshëm mund të ngrihet befaz në lartësinë e mikut, nuk e zbeh, përkundrazi, e lartëson shumë diinjitetin e tij”.

Elementi i gjakmarrjes ka të bëjë direkt me fatin e personazhit, sikurse që është I lidhur rubini (shiriti) rreth krahut të tij, për rrjedhojë edhe me vdekjen e tij. Personazhi në gjakesi detyrimisht është I lidhur me rrjedhën e përgjakshme të Kanunit., dhe ghakemarrësit janë të vtedijshëm për kanunin ose behen të vetedishëm nga paraardhësit e tyre. Në të vërtetë, ky është thelbi i tij. ... Bota ishte e ndarë në dy pjesë: në pjesën që kishte për të dhënë ose për të marrë gjak dhe në pjesën tjetër, që ndodhej jashtë gjakmarrjes.”

Ekranizimi i letërsisë

Sa për të dhënë një argument informues, "Prilli i thyer" është ekranizuar për film artistik tri herë. Versioni i parë ka qenë shqiptar, i dyti francez dhe i treti brazilian. Ne do ndalemi të analizojmë versionin e fundit të ekranizimit atë brazilian ku mendojmë se ka shumë elemente për debat shkencor dhe për të nxjerrë përfundime shkencore rreth ekranizimit të letërsisë.

Raportet mes arteve janë të heshme duke filluar nga antikiteti ku artet bashkëjetonin mes vete brenda sinkretizmit artistik. Mirepo sa për ta shpjeguar teatri është një skenë e vjetër ndërsa filmi është relativisht një skenë e re dhe moderne. Pra letërsia nëse me teatrin ka qenë e lidhur që nga antika, letërsia me filmin ka pasur dhe mundësi të kete vetem një lidhje të vonshme, duke filluar nga shekulli 20 e ketej.. Studimi jonë ka për qëllim të nxjerrë në pah të përbashkëtat domethënëse ndërmjet filmit dhe letërsisë që është pjesë e një debati të vazhdueshëm i cili nuk përmbillet asnjëherë. Madje, edhe studiuesit e letërsisë por edhe atë të teorisë së „filmit të pastër“, apo më mirë thënë i filmit i cili duhet të jetë më shumë një spektakël imazhologjik se çfarëdoqftë tjetër, nuk mund ta shmangin apo edhe ta mohojnë rëndësinë dhe ndikimin e madh që ka ushtruar letërsia tek filmi. Kemi analizuar duke shqyrtuar një seri librash

shkencor dhe të kësaj fushe, pra filmokratisë dhe teorive letrare dhe të adaptimit, ku shume skenare te filmave te sukseseshem jane botuar dhe lexohen si krijimtari letrare.

Ekranimi i filmit behet me kualitativ dhe realizohet me lehte nga drama ,sesa raatizimi i nje vepre leterare nga proza ose romani.siq kemi filmin “ Amarcord” i regjisorit Federico Fellini , pastaj filmi “A space Odyssey: 2001”i regjisorit Stanley Kuibrick dhe filmi “ Alien” nga regjisorit Ridley Scott te cilet filma kishin nje sukses te jashtezakonshem ne kinema por ndonese u bene libra dhe kurr nuk u shenderruan ne letersi te sukseseshme.

Mirepo eshte e kunderta e romanit ne film, perkatesisht e ekranizimit te disa prej prozave me te sukseseshme ne mbare krijimtarine artistike. E theksuam se romani nuk eshte zhanri me i pershtateshem per punen e regjisorit dhe ketu atij i hyn ne pune nje skenarist me shume pervoje i cili romanin le te themi te perzgjedhur do ta shoshise, do te perpunoje, dhe do ta shenderroje ne nje material qe do te jete faza finale para filmit ose e tera ajo qe do te shenderrohet ne kinema.Pjesa tjeter e lene jashte materjes se skenarit mund ti perkas letersise ose te mbetet vetem shprehje e gjuhesise

Romanet te cilat kane pasur nje sukses ne film mund te cekim filmin: Dr Zhivago i shkrimtarit Boris Pasternak, Dracula i Bram Staker, “ The Shining “ i autorit Stephan King.

Gjuha e letërsisë dhe gjuha e filmit – analizë gjuhësore-

Numri i veprave letrare që janë ekranizuar është nje numer i konsiderueshem dhe ka sjellë projekte të sukseseshme filmike. Mirpo nuk mund të jetë psotësisht e njejtë sepse libri mund ti ketë 300 faqe kurse filmi do te jete 3 orë prandaj reduktohet ne nje skenar.. sikundër e thotë edhe Alfred Hiçkok (Alfred Hitchcock), intensiteti i krahasueshmërisë se a është më i mirë romani apo filmi, nuk kanë pushuar kurrë

Duhet theksuar se sado që filmi ruan ngjarjen origjinale të veprës letrare shqipe, po aq edhe pastaj largohet. Në këtë mënyrë filmi ruan fabulën, por jo edhe dialogun. Në roman nuk e kemi këtë dialog për kërkim të besës mes familjeve, madje kërkesa për besë bëhet nga një Pleqësi e caktuar e gatshme, që hyn e del nëpër portat e kullave dhe kumton lajmin. Në roman kemi autorin, i cili komenton ngjarjet shpeshherë përmes meditimeve të personazheve, ndërsa në film kemi një narrator. Ky narrator (personazh) është vëllai i vogël, e i paemër i Tonho-s që e quajnë "Çun". Në roman, ndërsa është personazhi i motrës së Gjorgut. Gjorgu është personazhi kryesor në roman dhe rrëfimi fillon me te, dhe skenën e pritjes, ekzekutimin, kthimin në kullë, shkuarjen tek gjakësit, dhe pastaj tek Kulla e Oroshit për të paguar taksën. Këtu rrëfimi ndërpritet dhe kalon tek ndodhitë e çiftit Vorpsi, një dyshe nga qyteti që vijnë në Malësi për muajin e mjalitit dhe me ç'rast bëhet një gërshetim ndjenjash keqardhje, përdëllimi e afeksioni mes Gjorgut dhe gruas së re, Vorpsi, që udhëtojnë nëpër Malësi me një karrocë të kadifenjtë.

Pra, brenda vetë romanit kemi një ndëthurje strukturore por edhe narrative të ngjarjes, por kryesisht me protagonist Gjorgun në qendër të ngjarjes, dhe me një kërkim të një lidhje dashurie, ndërsa tek filmi brazilian kemi Tonho-n, i cili duket më i shkujdesur dhe më i dhënë pas lirisë sesa traditës duke shkitur në një lidhje dashurie me gruan e shfaqjes nga cirku. Burri që udhëton me Clara-n është njerku i saj. Njerku i thotë, mos shko me një të vdekur, meqë e vene ne pah rubin e zi rreth dorës se Tonho-s, por çfarë, i përgjigjet Clara, ë? Ia kthen kështu; "Por, unë jam një e gjallë"! qe na bene te mendojme per qasjen qe na tregon regjisorit ndaj filmit, ndaj skenarit dhe pastaj edhe ndaj romanit të Kadaresë.

Mirëpo, nëse do ta perifrazonim Alfred Hiçkok (Alfred Hitchcock) mund të thuhet edhe se, nuk është e domosdoshme që një libër të jetë shumë i mirë për ta bërë realizimin e një filmi të suksesshëm. Hiçkoku e thotë se: “Mund ta realizojë një film shumë të mirë nga një libër i keq. Ndërsa mund ta punoj një film të shkëlqyeshëm edhe nga një libër tejet mesatar, por, është e

vështirë që kjo të bëhet nga një libër shumë i mirë ngase ai film, përjetësisht do të ‘vuaj’ nga krahasimet që i bëhen me veprën origjinale”. Dhe pyetja se a është me i mire romani apo filmi gjithmone ekziston.

Përshtatje, rikrijim apo adaptim?

Është e një rëndësie të madhe shkencore që është një objekt shtjellues dhe hulumtues analiza e raportit mes romanit dhe filmit. Përshtatja e cilana del si e para mundësi terminologjike është objekt i hulumtimit dhe shtjellimit në këtë proces. Në këtë çështje studimi të një romani dhe si ai kalon në film kemi shumë përshtatje sesa adoptim. Situata të ndryshme skenike secila e ndryshme në natyrën e përshtatjes duke filluar nga romanet, tregimet e shkurtra, këngët, poezitë dhe shfaqjet. Ndërsa shumë më i ngjeshur është problemi i përshtatjes nga romani në një skenar filmi.

Vetë natyra e romanit si vepër kompozicion le në prozë që shtjellon përmbajtjen dhe përmbajtjen narrative të personazhit në rastin tone Gjorgut, si dhe përshtatjen e saj me skenarin e filmit, paraqet një sfidë kërkimore përshtatjeje. Kur një personazh në një roman përshtatet me një skenar filmi me shumë personazhe, atëherë sfida e përshtatjes do të jetë edhe më e madhe. Çështja thelbësore qëndron në narrativën e përmbajtjes. A kemi një personazh në roman ku edhe i njëjti subjekt duhet përshtatur në një medium tjetër - një skenar filmi, i cili do të ketë më shumë se një personazh?!

Në këtë aspekt lind pyetja se sa do të ruhet përshtatja e frytshme, ideja, mesazhi dhe përmbajtja kryesore që është zhvilluar?!

Prandaj, pyetjet bëhen dhe janë nga një rreth më i gjerë. Pyetjet e bëra mund të jenë të drejtpërdrejta ose të tërthorta në këtë proces.

Prandaj, lënda e hulumtimit në rastin tonë, që është përshtatja nga romani në skenarin e filmit, është thelbësore për këtë trajtim. A do të përdoret teksti i personazhit nga romani deri te skenari i filmit; nëse teksti i romanit do të përshtatet apo zëvendësohet me përshkrime të situatave në skenarin e filmit; si do të zgjidhet problemi me personazhin që është i vetëm në roman, duke i ndarë personazhet e tjerë nga skenari i filmit; sa e drejtë duhet ta quajmë përshtatje nëse kemi ndryshime rrënjësore?

Përfundimi

Duke ditur që procesi i përshtatjes nga romani në film në aspekt praktik është mjaft i theksuar sot, dhe se ka një mori romanesh që kanë kaluar këtë sfidë nga përmbajtjet e ndryshme dramatike në skenarin e filmit, mund të themi se përvoja praktike profesionale nga romani deri te skenari filmik është shumë e rrallë dhe mund të themi se pothuajse askund nuk është eksperimentuar. deri më sot. Origjinaliteti i studimit tone është pikërisht të romanit i autorit më të mire shqiptar Ismail Kadare Prilli i thyer dhe si ekipi specialistësh filmik Brazilian. Këtë krahasim e gjetëm si të vecantë për studim, dhe se ky rast nuk është i vetëm ku romani Kadaresë merret dhe bëhet film.

Prandaj, rezultati i pritur i këtij studimi është përfundimi se thjesht në cilësinë e produktit përfundimtar në skenarin e filmit pamë imazhe të këndshme dhe emocion të vecantë ku sheh të ekranizuar një roman shqiptar. Rezultatet e aspektit epistemologjik dhe metodologjik janë origjinalitet i këtij lloji që kalon në procesin profesional dhe eksperimental produktional. Të gjitha rezultatet çojnë në përfundimin e një procesi shumë interesant artistik dhe krijues, që e bën përshtatjen e këtij romani edhe më interesante se ndoshta produkti përfundimtar i procesit. - skenari i filmit del më mbushamendësh dhe mështrësues në kujtësën e shikuasit.

Rezultatet e procesit të kërkimit tonë nga romani tek skenari i filmit deri në përfundim sjellin imazhin e filmit, fotografimin e filmit, mjedisin filmik, duke përfshirë gjuhën e personazheve dhe komunikimin në film, në krahasim me monodramën dhe trajtimin e saj.

Produkti final - skenari i filmit i adoptuar nga monodrama mund të sjellë një produkt vërtet origjinal, por edhe procesi i adoptimit nga monodrama në skenar filmi është një proces shumë i veçantë, i detajuar dhe delikat.

Një qasje e tillë kërkimore e jonë e bazuar në praktikën artistike, nga metoda të ndryshme të adoptimit, rikrijimit dhe përshtatjes gjithë këto të lejuara për eksperimentime të këndshme artistike, sjell dhe një plotësim të studimeve të kësaj natyre në fushën e shkrimeve filmologjike, romanore, artistike.

Referencat

- [1]. Morris, Beja, "Filmi dhe Letërsia", Longman Inc., Nju Jork, 1979, f. 224.
- [2]. Bazin, André, "Çfarë është filmi, I: Ontologjia e gjuhës", Instituti i filmit, Beograd, 1967, f. 96-97.
- [3]. Kadare, Ismail, "Prilli i thyer", Rilinja, Prishtinë, f. 53.
- [4]. Harwood, Ronald, "Dita e të Gjithë Shenjtorëve është një skenë", Secker dhe Warburg, Londër, 1984, f. 218.
- [5]. Muliqi, Shprese, gazeta e përditshme "Epoka e re", "Prilli i thyer" ose përpjekja për të interpretuar kodin e vjetër zakonor shqiptar, Pristinë, 16.05.2015.
- [6]. Filmi u shfaq për herë të parë në BRSS më 20 mars 1972 dhe në Festivalin e Filmit në Kanë më 13 maj 1972.
- [7]. "Bibla", Realizmi, Zagreb, 1969, Abrahami I Isaku.
- [8]. Për të shkruar skenarin e filmit "Prilli i Thyer", më shumë se një herë, shkrimtarit anglez, laureatit të çmimit Nobel, Harold Pinter (jo një mik aq i madh i shqiptarëve /sidomos gjatë luftës në Kosovë) iu ofrua vetë, por askush nuk ia dha këtë mundësi.
- [9]. Daiches, David, "Romani dhe Bota Moderne", Shtëpia Botuese e Universitetit të Çikagos, Çikago dhe Londër, f. 229
- [10]. Filmi fitoi 7 çmime Oscar, midis 28 çmimeve dhe 17 nominimeve që pati në festivalet më prestigjioze në mbarë botën. Ndërsa Oscari u fitua edhe për Skenarin më të Mirë të Përshtatur, ose siç quhej në atë kohë, për Skenarin më të Mirë të Përshtatur, vepër e skenaristit Kurt Luedke. Meryl Streep dhe Robert Retford luajnë rolet kryesore në këtë film.
- [11]. Filmi u vlerësua shumë nga publiku dhe kritikët e filmit, ndërsa Meryl Streep, e cila shfaqet në rolin kryesor, përkrah Clint Eastwood, u nominua madje për çmimin prestigjioz të Akademisë Amerikane të Filmit. Rolet kryesore luhen nga Ryan Gosling dhe Rachel McAdams, të cilët, sipas kritikëve, ishin të mrekullueshëm në këtë film të Nick Cassavetes.
- [12]. Solar, Milivoj, "Teoria e Letërsisë", Libri Shkollor, Zagreb, 1976, f. 249.
- [13]. Bazin, André, "Çfarë është filmi, I: Ontologjia e gjuhës", Instituti i filmit, Beograd, 1967.
- [14]. Bibla, realiteti, Zagreb, 1969, Abrahami dhe Isaku.
- [15]. Baudrillard, Jean, "Simulacrum and Simulation", Novi Sad: Svetovi, 1991.
- [16]. Butler, Christopher, "Postmodernizmi: Një hyrje shumë e shkurtër", Oxford: OUP, 2002.
- [17]. Butler, Christopher: "Modernizmi i Hershëm: Letërsia, Muzika dhe Piktura në Evropë 1900-1916", Oxford: Oxford University Press, 1994.
- [18]. Konrad, Joseph, "Zemër e zbutur", Libër shkollor, Zagreb, 1999.
- [19]. Daiches, David, Romani dhe Bota Moderne, Shtëpia Botuese e Universitetit të Çikagos, Çikago dhe Londër, Monaco, James, "Si të Lexohet Filmi: Filmat," Multimedia (botimi i 3-të), NY-Oxford: Oxford UP, 2000, (2008 Adam J. Jacobsen), f. 83.
- [20]. Dragović, Nono, "Poetika e regjisë filmike", Pancevo, Mali Nemo, 2006.
- [21]. Fontana, Nigel: "Nëntokë: Shtypi Alternativ i Londrës, 1966-74", Londër: Routledge, 1988.
- [22]. Génette, Gerard, "Palimpsestes: Letërsia në Shkallën e Dytë", Universiteti i Nebraskës
- [23]. Jeffrey, "Historia e Oksfordit e Kinemasë Botërore. Oksford", Oxford UP, 1996.
- [24]. Giannetti, Louis, "Të Kuptosh Filmat", (botimi i gjashtë), New Jersey: Prentice Hall, 1993.
- [25]. Gregor, Ulrich, Patalas, Eno, "Historia e Artit të Filmit 1, 2, 3", Beograd, Instituti i Filmit, 1977.
- [26]. Hall, Phil: "Enciklopedia e Filmave Underground: Filma nga Margjinat e Kinemasë," Studio City, CA: M&P, 2004.
- [27]. Hardwood, Ronald, Historia e teatrove – CEO Svet je Pzdsnica, Clio, Beograd, 1998.
- [28]. Hristić, Jovan, "Format e letërsisë moderne", Beograd, Nolit, 1968.

- [29]. http://ëëë.zemrashqiptare.net/neës/id_36955/Gani-Mehmetaj:-Rilexime-interesante-t%C3%AB-Prilli-i-thyer.html
- [30]. Conrad, Joseph, "Zemra e Errësirës", Libri Shkollor, Zagreb, 1999, f. 337.
- [31]. Kadare, Ismail, "Dialog me Alain Bosquet", Sh.B. Onufri, 1996.
- [32]. Kadare, Ismail, botimi "Prilli i Thyer" nga Rilindja, 1980.
- [33]. Krstic, Dragan, "Filozofia e filmit", botim i autorit, Subotica, 2007.
- [34]. Krstic, Dragan, "Filozofia e filmit", Subotica: botim i autorit, 2007.
- [35]. Cook, David A., "Historia e Filmit II. Beograd", Clio, 2007.